

Бр. 01-30/3

16.03.2021 год.

ОХРИД

Në pajtim me nenin 26-a nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal ("Gaz.Zyrtare e RMV" nr.63/2007, 187/2013, 43/2014, 215/2015 dhe 64/2018) dhe në bazë të nenit 12 nga Vendimet e themelimit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Udhëheqësja e Qendrës e dorëzon këtë

RAPORT FINANCIAR

për punën e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2020

1. Themelimi dhe qëllimet e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

Qendra për zhvillim rajonal u themelua nga 9 (nëntë) njësitë e qeverisjes vendore të cilat janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimor. Qendra për zhvillim i përmbaron punët administrative dhe profesionale për Këshillin për zhvillim, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e rajonit planor Jugperëndimor, përkatësisht në drejtim të realizimit të objektivave dhe parimeve të politikës së zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm.

2. Burimet e financimit

Në pajtueshmëri me nenin 27 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, të hyrat e financimit për aktivitetet dhe programet e punës të Qendrën për zhvillim rajonal realizohen nga burimet në vijim:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë
- Buxheti i NJVL
- Fondet nga Unioni Evropian
- Burime tjera ndërkombëtare
- Donacionet dhe sponsorimet nga individët dhe subjektet juridike
- Mjete të tjera të përcaktuara me ligj

3.Realizimi i Planit financiar

Në bazë të qëllimeve të përcaktuara dhe burimeve të të hyrave të përcaktuara me ligj, duke u nisur nga programet dhe nevojat për funksionim pa pangesa të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Këshilli për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e miratoi Planin Financiar për punën e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019, në seancën e mbajtur më __.03.2020.

Në raportin financiar janë paraqitur të dhënat nga dy llogaritë e Qendrës për zhvillim, nga të cilat njëra është themelore dhe një nën llogari të cila u hap për projekte nga donatorët. Për çdo llogari janë përgatitur llogari përfundimtare të veçanta për vitin 2020 dhe të njëjtat janë dorëzuar deri te Regjistri qendror i RMV në afatin e përcaktuar ligjor.

3.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara i kushtohen periudhës nga 01.01.2020 deri në 31.12.2020 dhe ishin të përcaktuara me shumën e përgjithshme prej 100.889.331 denarë.

Në periudhën prej 01.01.2020 deri në 31.12.2020 janë realizuar të hyra në vlerë prej 76.439.421 denarë, nga të cilat 67.203.841 denarë në llogarinë themelore të Qendrës, ndërsa në nën llogarinë e projektit nga donatorët “Zhvillimi i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” me shumë prej 9.235.580 denarë. Realizimi në të hyrave e shprehur në përqindje është 75,76% nga të hyrat e planifikuara me planin Financiar për vitin 2020. Vlerat e mjeteve të bartura nga buxheti i vitit 2019 në buxhetin e vitit 2020 në llogarinë themelore është 31.207.837 denarë, dhe në nën llogarinë e “Zhvillimi i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” janë bartur mjete prej 680.684 denarë.

Në pajtim me Marrëveshjet e veçanta të nënshkruara në mes Komunave dhe Qendrës për zhvillim të RPJP deri në fund të vitit 2020, janë realizuar të hyra si kontribut vetanak i komunave në projektet rajonale të financuara nga programet nacionale dhe projektet e donatorëve në vlerë prej 2.907.582 denarë. Ngelin edhe 1.132.047 denarë që të paguhen nga ana e komunave.

Me rëndësi është të theksohet se në raport me të hyrat e planifikuara për punën vijuese të Qendrës në bazë të transfereve nga buxhetet e NJVL të cilët participojnë në rajonin planor Jugperëndimor dhe MVL, janë realizuar 37,08 % nga të planifikuarat ose e thënë në vlerë nominale nga të planifikuarat 9.415.567 denarë, janë realizuar vetëm 3.491.500 denarë.

3.2 Shpenzimet

Për shkak të devijimit të të hyrave të planifikuara dhe të realizuara, reflektohet edhe dispartiteti i paraqitur i shpenzimeve të përcaktuara me Planin financiar dhe shpenzimeve të realizuara.

Në vitin 2020 janë realizuara shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 58.965.675 denarë nga të cilat 54.051.425 denarë nga llogaria themelore, nga nën llogaria “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” (SDC-MVL) 4.914.250 denarë.

Të paraqitura në strukturë shpenzimet janë realizuar për harxhimet e mëposhtme:

- për shpenzime kapitale përkatësisht aktivitete të projekteve në kuadër të projekteve rajonale të siguruara në vitin 2019 dhe vitin 2020 nga burime buxhetore dhe donatorë, janë shpenzuar 53.394.293 denarë ose 90,55 % nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- për rroga, kontribute, dhe tatime për të punësuarit në Qendër janë realizuar shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 2.582.756 denarë ose 4,38% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- për shërbime komunale, komunikim, transport dhe shpenzime rruge janë realizuar shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 512.808 denarë ose 0,87 % nga shpenzimet e përgjithshme.

- për shpenzime tjera rrjedhëse janë harxhuar 489.400 denarë ose 0,83 % nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- për shërbime tjera kontraktuale të ndërlidhura me punën vijuese të Qendrës (mbikëqyrje, konsulent, higjiena, kontabilitet, kopjim dhe botim, përkthim, lektorim) dhe me realizimin e aktiviteteve të projekteve nga nën llogaritë e donatorëve (trajnime, forume, punëtori) janë realizuar 990.469 denarë ose 1,68 % nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- dhe për materiale dhe inventar të imët për riparime dhe mirëmbajtje janë shpenzuar 158.773 denarë ose 0,27% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- për punësime të përkohshme janë shpenzuar 124.593 denarë ose 0,21% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- për transferim të ndërlidhura me kthimin e mjeteve në buxhetin nacional 405.022 denarë ose 0,68% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

- për blerje të mjeteve dhe softuer janë shpenzuar 283.418 denarë ose 0,21% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2020.

4. Detyrimet e Qendrës

Në pajtim me Ligjin për kontabilitet për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetor nuk zbatohet plotësisht parimi i harmonizimit të angazhimeve dhe pagesës së njëjtë në vitin aktual buxhetor. Qendra për zhvillim detyrimet e krijuara për punën vijuese, projektet rajonale të realizuara në vitin 2020 dhe detyrimet nga projekti i donatorëve “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” nuk i ka realizuar në tërësi me çka ka bartur detyrime në vitin vijues në shumë prej 9.119.400 denarë, si dhe detyrimet e pa realizuara duke përfshirë datën 31.12.2020. Nga shuma e përgjithshme e përmendur e detyrimeve 9.119.400 denarë janë nga llogaria bazë për realizimin e aktiviteteve të projekteve, dhe shpenzime për punën vijuese, ndërsa nga projekti i donatorëve 12.300 denarë.

5. Kërkesat

Kërkesat e përgjithshme duke përfshirë datën 31.12.2020 në pajtim me evidencën kontabilistike janë 14.509.638 denarë. Në këtë vlerë janë kalkuluar mjete nga Komunat për punën vijuese të Qendrës në vlerë prej 5.699.187 denarë, për kontribut vetanak të Komunave në projekte rajonale në vlerë prej 1.132.047 denarë si dhe nga Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural për projektet e realizuara me vlerë prej 7.678.404 denarë.

Në pajtim me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal dhe Vendimet për themelim të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, detyrim është që çdo Komunë të participojë për punën vijuese të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në shumë prej 10 denarë për banor. Sipas parametrave të përcaktuara, por edhe në pajtim me Marrëveshjet për kofinancim të Qendrës për periudhën 2009 deri në 2020, nënshkruar ndërmjet Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe komunave në përbërje të rajonit planor Jugperëndimor, dhe në pajtim me Vendimet për themelim, për vitin 2020 për këtë qëllim Qendra duhej të realizojë të hyra të përgjithshme në vlerë prej **9.415.567** denarë. Nga të hyrat e planifikuara për këtë qëllim duke përfshirë datën 31.12.2020 janë realizuar gjithsej **3.491.500** denarë, dhe ajo është në bazë të pagesave të komunave dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale.

Duke përfshirë datën 31.12.2020, vetëm dy komuna (Ohri dhe Qendër Zhupa) në tërësi i kanë shlyer detyrimet për punën vijuese të Qendrës për zhvillim të RPJP. Njëra komunë (Pllasnica) për periudhën 2009-2020, në asnjë rast nuk ka paguar mjete për punën vijuese të

Qendrës. Në vitin 2020 pesë komuna (Ohri, Struga, Vevqani, Makedonski Brod dhe Qendra Zhupë) kanë paguar mjete për punën vijuese të Qendrës për zhvillim ndërsa katër komunat e tjera (Debërca, Dibra, Kërcova dhe Pllasnica) nuk kanë paguar asgjë.

6. Projekte nga donatorët

Në vitin 2020 vazhduan aktivitetet e projektit në lidhje me “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”- për të cilën u hap nën llogari donatore me numër 880006121278553. Prej kësaj llogarie janë kryer transaksione për aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit.

Në pjesën e parë të këtij raporti janë të përfshira të gjitha ndryshimet në këtë llogari. Detaje për realizimin e aktiviteteve të projektit janë dhënë në Raportin për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, dhe në Raportin e punës së Qendrës për zhvillim të RPJP për vitin 2020.

7. Furnizimet publike

Në periudhën prej Janar deri në Dhjetor të vitit 2020 Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti 15 furnizime publike nga të cilat 8 furnizime publike janë realizuar në përgjithësi, një furnizim është shpallur për herë të dytë dhe është realizuar, një furnizim publik është rishpallur dhe është realizuar për herë të tretë, ndërsa një furnizim publik është shpallur dhe është realizuar për herë të katërt, ndërsa një furnizim publik nuk u realizua sepse u anulua. Nga numri i përgjithshëm (15) - 11 u realizua si procedurë e hapur e thjeshtë, një si furnizim me vlerë të vogël dhe njëra si Procedurë e hapur, ndërsa dy janë Bisedime pa shpallje publike.

Nga furnizimet publike të realizuara 14 janë të lidhura me implementimin e projekteve rajonale dhe vetëm një për punën vijuese të Qendrës për zhvillim. Vlera e përgjithshme e marrëveshjeve të nënshkruara për të gjitha furnizimet është **25.040.651**denarë me TVSH të përlllogaritur. 13 Furnizime janë të realizuara në formë elektronike përmes Sistemit elektronik për furnizime publike të Byrosë për furnizime publike, ndërsa dy furnizime kanë përfunduar me bisedime pa shpallje publike me kriterium çmimi më i ulët.

Përveç këtyre, në pajtim me Rregulloren e donatorit për realizimin e një pjese të aktiviteteve nga projekti “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, e financuar nga ana e Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale

është realizuar një furnizim në tre pjesë edhe atë në përgatitjen e Programit për zhvillim në RPJ për periudhën 2020-2024, organizimi i 2 forumeve rajonal, angazhimi i ekspertëve për përgatitjen e propozim projekteve rajonale për vitin 2021 si dhe angazhim për moderator të forumeve . Shuma e përgjithshme e marrëveshjeve është 678.592 denarë.

Të gjitha të dhënat janë të paraqitura me afatet ligjore deri tek Byroja për furnizime publike dhe të cilat janë të shpallura në sistemin elektronik për furnizime publike.

Përcaktim më të afërt të hyrave sipas burimeve dhe qëllimit të shpenzimeve sipas shfrytëzuesve dhe zërave është dhënë në llogarinë vjetore.

Strugë, 23.02.2021

Qendra për zhvillim të
rajonit planor Jugperëndimor
Udhëheqëse
M-r Mirjana Lozoska